



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2021





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2021



Prishtinë, 2022

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)
Data e botimit: Nëntor / 2022
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturive Komunale (AMK) për vitin referues 2021, si anketë e rregullt vjetore

Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroj të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturive komunale në Kosovë.

Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Metodologjia e përdorur për realizimin e anketës së lartpërmendur është në përputhje me Ligjin për Mbeturinat në Kosovë (Nr. 02/L-30 dhe Nr.04/L-60), si dhe me Rregulloren (EC) Nr. 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 nëntorit 2002 mbi statistikat e mbeturive, Listën e Kodeve të Mbeturive, Direktivën Kornizë për Mbetjet (WFD 2008/98/EC) dhe me Klasifikimi i mbeturive sipas Katalogut Evropian të Mbeturive.

Falënderimet i dedikohen ekspertit nga GOPA, Volker Küchen (ARGUS GmbH, Berlin) për mbështetje profesionale.

Publikimin përgatiten:

Bajrush Qevani - Drejtor i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Haki Kurti - Shef i Divizionit të Statistikave të Mjedisit

Flutura Shosholli - Zyrtare e Statistikave të Mjedisit

Nëntor, 2022

Z.v. i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK-së,
Ilir T. Berisha

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KRM	-	Kompani Rajonale e Mbeturinave
DSBM	-	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DS	-	Deponitë sanitare
Kg	-	Kilogram
T	-	Ton
kg/v	-	Kilogram në vit
kg/d	-	Kilogram në ditë
%	-	Përqindje

Përmbajtja

	Faqe
1 Shpjegime Metodologjike	8
2 Rezultatet e Anketës së Mbeturive Komunale 2021	9
Tab. 1: Mbeturit komunale të grumbulluara në vitin 2021	9
Tab. 2: Mbeturit e grumbulluara sipas regjioneve për vitet 2012-2021, t/, kg banorë/vit, kg/banorë/ditë.....	10
Tab. 3: Mbeturit komunale të grumbulluara sipas rajoneve për vitin 2021	11
Aneksi i Pyetësorit.....	12

1 Shpjegime Metodologjike

Objektivat

Objektivi i anketës së mbeturinave komunale 2021, ka qenë që të sigurojë të dhëna statistikore për mbeturinat komunale si më poshtë vijon:

- Gjenerimin e mbeturinave komunale dhe
- Trajtimi i mbeturinave komunale

Gjithashtu ka pasur për qëllim monitorimin e vazhdueshëm të sektorit të mbeturinave.

Metodologjia

Korniza e anketës

Në Qershor 2022 janë bërë të gjitha përgatitjet metodologjike për realizimin e AMK 2021 si vijon:

- Nga regjistri i bizneseve është nxjerrur lista e bizneseve dhe mostra e anketës,
- Përgatitja e pyetësorit dhe udhëzuesit.
- Mostra e AMK 2021, është përbërë prej 22 bizneseve, të gjitha bizneset janë përgjigjur në anketë.

Procedurat në terren

Puna në terren është realizuar gjatë periudhës kohore Korrik-Gusht 2021, nga anketuesit e zgjedhur sipas Vendimit të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve. masa 1.4 – Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për punë praktike në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Gjatë periudhës së lartpërmendur anketuesit kanë zhvilluar intervista të drejtpërdrejta me menaxherët e kompanive rajonale për menaxhimin e mbeturinave komunale (KRM), në bazë të pyetësorëve.,(Shtojca 1). Grumbullimi i të dhënave të AMK 2021, pjesërisht është realizuar në mënyrë elektronike.

Definicioni

Mbeturinat Komunale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

2 Rezultatet e Anketës së Mbeturive Komunale 2021

Tab. 1: Mbeturinat komunale të grumbulluara në vitin 2021

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar 1000/ton	Popullsia ¹	Mbeturina të grumbulluara	
			kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Prishtina dhe Rajoni ²	151	493.466	305	0,84
Rajonet tjera	334	1.280.505	261	0,71
Gjithsej Kosova	485	1.773.971	273	0,75

Në Kosovë në vitin 2021 janë grumbulluar gjithsej 485 mijë ton mbeturina komunale. Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2021, ka rritje për 6.4 %, krahasuar me vitin 2020.

Të dhënat e vitit 2021 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ishte 273 kg për banorë në vit. Ndërsa mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ishte, 0.75 kg.

Në Prishtinë dhe rajonin e saj, grumbullimi i mbeturinave komunale për ditë ishte 0.84, kg/ banorë/ditë. Në rajonet tjera të Kosovës sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ishte 0.71, kg/banorë/ditë (shiko tabelën 1).

Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2021, në Prishtinë dhe rajonin e saj ka rritje për 6.3 %, krahasuar me vitin 2020.


Ndërsa gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2021, në rajonet tjera ka rritje për 6.4 %, krahasuar me vitin 2020.

¹ASK, Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2020 (31 dhjetor 2020).

²Prishtina, Obiliqi, Drenasi, Fushë Kosova, Lipjani, Graçanica, Podujeva.

Tab. 2: Mbeturinat e grumbulluara sipas rajoneve për vitet 2012-2021, t/kg/v, d


Vitet	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Njësia	në 1000 ton									
Prishtina dhe Rajoni	249	255	95	105	105	115	110	139	142	151
Rajonet tjera	358	320	152	214	289	294	297	313	314	334
Kosova gjithsej	607	575	247	319	395	409	407	452	456	485
Njësia	në kg/banorë, v									
Prishtina dhe Rajoni	515	517	193	214	221	235	223	282	285	305
Rajonet tjera	269	242	119	163	224	225	228	242	241	261
Kosova gjithsej	334	317	140	177	223	228	227	253	253	273
Njësia	në kg/banorë, d									
Prishtina dhe Rajoni	1,41	1,41	0,50	0,60	0,60	0,60	0,61	0,77	0,78	0,84
Rajonet tjera	0,70	0,66	0,30	0,50	0,61	0,61	0,62	0,66	0,66	0,72
Kosova gjithsej	0,90	0,86	0,40	0,50	0,61	0,61	0,62	0,69	0,69	0,75

Fig. 1: Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas rajoneve, 2012-2021 (1000/t)

Tab. 3: Mbeturinat komunale të grumbulluara sipas rajoneve për vitin 2021, t/kg/v, d

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar	Popullsia	Mbeturina të grumbulluara	
	1000/Ton		kg/banorë/vit	kg/banorë/ditë
Prishtina	151	493.466	305	0.84
Ferizaj	37	183.898	202	0.55
Gjakovë	48	197.067	245	0.67
Gjilan	43	155.235	280	0.77
Mitrovicë	66	220.398	298	0.82
Pejë	57	178.565	321	0.88
Prizren	82	345.342	239	0.65
Gjithsej	485	1.773.971	273	0.75

Në tabelën 3, janë paraqitur të dhënat vjetore të mbeturinave komunale të grumbulluara sipas rajoneve, me ç' rast vërehet se sasia më e madhe e mbeturinave të grumbulluara është në rajonin e Prishtinës, 151 mijë t/vit, ndërsa sasi më e vogël e mbeturinave të grumbulluara vërehet në rajonin e Ferizajt, 37 mijë t/vit ose 202 kg për banorë në vit.

Fig. 2: Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas rajoneve në vitin 2021, t/vit

Agjencia e Statistikave te Kosovës:

Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Tani ky Agjencion vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojn edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruer terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenei Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>